



Qendra për Arsim Demokratik

Përfshirja e prindërve në jetën e shkollës në Shqipëri

Raporti i studimit të kryer në kuadër të projektit

Përparimi i përfshirjes dhe cilësisë në arsim në Evropën Juglindore

Mbështetur nga

Programi për Mbështetjen e Arsimit pranë Institutit për Shoqërinë e Hapur

Mars 2010

Përgatitur nga

Elona Boce

Përmbajtja

Falenderime	2	
Shkurtime dhe akronime	3	
Lista e tabelave dhe grafikëve	4	
I Prezantim	5	
1.1 Hyrje	5	
1.1.1 Mbi Projektin “Përparimi i përfshirjes dhe cilësisë në arsim në Evropën Juglindore”	5	
1.1.2 Konteksti ligjor i pjesëmarrjes në jetën e shkollës në Shqipëri	6	
1.1.3 Çështje mbi pjesëmarrjen e prindërve	7	
1.2 Metodologjia	8	
1.2.1 Objektivat e studimit	8	
1.2.2 Kampioni	8	
1.2.3 Procedurat e kampionimit	10	
1.2.4 Analiza e të dhënave	10	
II Gjetjet	11	
2.1 Një vështrim mbi variablat e përgjithshëm	11	
2.2 Dimensionet e pjesëmarrjes	12	
2.2.1 Takimet me prindër në shkollë	12	
2.2.2 Informacioni i shkruar për prindërit	13	
2.2.3 Mbështetja për të nxënësit	14	
2.2.4 Ndhim vullnetar	14	
2.2.5 Pjesëmarrja në vendimmarrje	15	
2.2.6 Roli i prindërve në shkollë (përfaqësimi në struktura)	17	
2.2.7 Bashkëpunimi shkollë – komunitet	17	
2.3 Faktorë parashikues dhe ndërmjetësues	18	
2.3.1 Qëndrimet ndaj bashkëpunimit shkollë – familje	18	
2.3.2 Perceptimi mbi hapjen e shkollës	19	
2.3.3 Romët	19	
2.3.4 Përfaqësuesit e prindërve në strukturat e shkollës	20	
2.4 Përfitimet e perceptuara të përfshirjes së prindërve	21	
III Përfundime dhe rekomandime	23	
3.1 Përmbledhje e gjetjeve nga variablat e përbërë	23	
3.2 Përfundime kryesore	24	
3.3 Rekomandime	25	

Bibliografi 28

Shtojca

Instrumenti i studimit

Raporti i grupeve të fokusuara

Falenderime

I jemi thellësisht mirënjohës të gjithë prindërve të cilët pranuan të bëhen pjesë e këtij studimi, drejtorëve të shkollave në studim dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës që bënë të mundur aksesin në shkolla.

Falenderojmë ekipin e kompanisë Ipsos Strategic Puls e cila zbatoi kryerjen e sondazhit në terren.

Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, mirënjohja i shkon ekipet e Programit për Mbështetjen e Arsimit pranë Institutit të Shoqërisë së Hapur, Qendrës për Studimet e Politikave të Arsimit (CEPS, Universiteti i Ljubljanes, Fakulteti i Edukimit), Fondacionet Kombëtare të Sorosit si dhe Organizatat e shoqërisë civile në fushën e arsimit në vendet e Evropës Juglindore. Këto ekipe të përkushtuara bënë të mundur që ky sondazh të realizohej edhe në Shqipëri.

Shkurtime dhe akronime

CDE	Center for Democratic Education
OSI	Open Society Institute
Unicef	United Nations Fund for Children

Lista e tabelave dhe grafikëve

Tabela 1. Shpërndarja e kampionit të shkollave sipas variablit të rajonit gjeografik dhe përkatësisë urbane/rurale 9

Tabela 2. Kampioni i prindërve i peshuar sipas zonave gjeografike të studimit 9

Grafik 1. Në lidhje me mbledhjet me prindërit, (takime klase, në grup apo individuale), a ndihet të paktën njëri në familjen tuaj i aftë dhe kompetent për të shfrytëzuar për mirë këtë lloj takimi? (në përqindje) 13

Grafik 2. Sa herë ka kërkuar shkolla mendimin tuaj në vitin e kaluar (personalisht apo familjarisht) në lidhje me çështje si përmbajtja e lëndëve, teksteve, vlerësimi i mësuesve etj? (në përqindje) 15

Grafik 3. A u munduat të ndikonit diçka bashkë me prindër të tjerë (pa ua kërkuar shkolla)? (në përqindje) 17

Grafik 4. Duke parë mbrapa në kohë format e ndryshme të pjesëmarrjes në jetën shkollore, sa dakord do të ishit me fjalitë e mëposhtme? (në përqindje) 18

I Prezantim

1.1 Hyrje

Në këtë raport, prezantohet gjetjet e studimit të në kuadër të projektit rajonal “Përparimi i përfshirjes dhe cilësisë në arsim në Evropën Juglindore” i mbështetur nga Programi për Mbështetjen e Arsimit pranë Institutit për Shoqërinë e Hapur (Open Society Institute, OSI).

1.1.1 Mbi Projektin “Përparimi i përfshirjes dhe cilësisë në arsim në Evropën Juglindore”

Përfaqësues të Institutit për Shoqërinë e Hapur nga dhjetë vende të Evropës Juglindore (Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Rumania, Serbia dhe Shqipëria) identifikuan prioritete të ngjashme të cilat duhej të adresoheshin nga OSI në rajon:

- Pabarazia në arsim, më saktësisht hendeku ndërmjet politikave ekzistuese dhe zbatimit të tyre, dhe neglizhimi ndaj formave të ndryshme të diskriminimit (p.sh. në lidhje me minoritetet, aftësinë e kufizuar e kështu me radhë)
- Pjesëmarrje e pamjaftueshme e aktorëve, veçanërisht nxënësve dhe prindërve, në sistemin arsimor dhe cilësi e dobët në arsim.

Për të adresuar këto shqetësime, projekti synon (1) të kuptojë më mirë shkaqet e pabarazisë në arsim, duke ndërmarrë sondazhe kombëtare me drejtorët e shkollave; si edhe (2) të mbështesë iniciativa të qëndrueshme në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal për të përmirësuar cilësinë dhe përfshirjen.

Faza e parë e projektit ka identifikuar prioritetet dhe ka ofruar fakte për fazën e dytë e cila ishte e orientuar ndaj advokimit. Gjatë fazës së parë, faktet e mbledhura kanë shërbyer për të kuptuar faktorët që pengojnë zbatimin e legjislacionit që ofron mundësi të barabarta në arsim në nivelin e shkollës. Aktivitetet e projektit ndahen në disa grupe:

- (a) sondazhet kombëtare me drejtorët e shkollave për të zbuluar aftësitë, vlerat, qëndrimet dhe praktikën e tyre;
- (b) sondazhet kombëtare me prindër, për të kuptuar nevojat, pritshmëritë dhe përvojat e tyre në drejtim të përpjekjeve që shkolla ka bërë për përfshirjen e tyre; dhe
- (c) kërkime vepruese me synim nxitjen e njëherazi iniciativa të reja komunitare si edhe të tilla të parashikuara në letër, të cilat vlerësohen si të suksesshme në drejtim të përmirësimit të cilësisë dhe përfshirjes në arsim.

Të gjitha aktivitetet e projektit u bazuan në të njëjtën skemë pune për të gjitha vendet pjesëmarrëse. Në të përfshihen një gamë aktorësh (përfaqësues të komunitetit, mësues, nxënës, prindër) të cilët ndihmuan për identifikimin e çështjeve si edhe për adresimin e tyre.

Përgjatë këtij projekti, i kushtohet vëmendje nevojës që të rinjtë të mobilizohen dhe nxiten për të marrë më shumë rol në luftën ndaj pabarazisë në arsim, duke përgatitur kështu themelin për një lëvizje kombëtare-rajonale rinore që do të çojë përpara kauzën e përfshirjes dhe cilësisë.

Faza e parë e këtij projekti u përmyll duke prezantuar dhe diskutuar gjetjet e sondazhit të drejtorëve të shkollave, si dhe duke bërë rekomandimet për fazën tjetër.

Faza e dytë kishte të bënte me hartimin dhe zbatimin e programeve të caktuara të bazuara në gjetjet e fazës së parë, në bashkëpunim me organizata kombëtare qeveritare dhe jo qeveritare, rrjetin e programeve të OSI dhe partnerë ndërkombëtarë. Nga analiza e raporteve kombëtare të fazës së parë, lindi ideja që gjetjet nga sondazhi i drejtorëve të pasurohen me të dhëna nga sondazhi i prindërve, i cili prezantohet në këtë raport.

Qëndrueshmëria e këtij projekti do të sigurohet nëpërmjet përpjekjeve të vazhdueshme, bashkëpunuese dhe koordinuese të advokimit të pjesëmarrësve në projekt, organizatave të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare publike dhe private ndaj autoriteteve kombëtare dhe lokale të arsimit për të zbatuar masat që reduktojnë pabarazinë dhe rrisin cilësinë e arsimit, si edhe për të mbështetur zhvillimin e iniciativave të reja drejt këtij qëllimi.

Studimi i paraqitur këtu është në vijim të sondazhit kombëtar të kryer gjatë periudhës maj-qershor 2008, me 300 drejtorë shkollash nga shkollat e vendit. Sondazhi i drejtorëve të shkollave hulumtoi mbi çështje si: a) veprimet e shkollës për përfshirjen e prindërve në jetën e shkollës; b) qëndrimet e drejtorëve të shkollave mbi përfshirjen e prindërve në jetën e shkollës; c) pengesat në krijimin e bashkëpunimit shkollë-prindër; dhe d) praktikën e pjesëmarrjes. Nga ana tjetër, sondazhi i prindërve u përqëndrua në dimensionet e pjesëmarrjes si takimet e prindërve në shkollë, informacioni i shkruar për prindërit, mbështetja për të nxënë, vullnetarizmi, pjesëmarrja në vendimmarrje, bashkëpunimi shkollë-komunitet; si dhe në variabla të tjerë parashikues si p.sh. pengesat në komunikim, perceptimi nëse shkolla është e hapur, përfaqësimin e prindërve, si edhe perceptimin mbi rezultatet që sjell përfshirja në shkollë.

Të dy sondazhet u paraprinë nga organizimi i fokus grupeve për diskutimin e këtyre çështjeve paraprakisht si me drejtorë të shkollave, edhe me grupet e caktuara të prindërve (prindër të zakonshëm, prindër minoritarë, prindër me gjendje ekonomike të dobët e kështu me radhë) nga rrethet e ndryshme të vendit.

1.1.2 Konteksti ligjor i pjesëmarrjes në jetën e shkollës në Shqipëri

Sipas Dispozitave Normative, prindërit kanë të drejtën t'i kërkojnë institucioneve të arsimit për të siguruar kushtet normale të arsimit, të kontribuojnë në progresin e procesit të arsimit, të kërkojnë informacion mbi programet, objektivat, rregulloret dhe aktivitetet e arsimit, të kërkojnë informacion mbi progresin e fëmijës së tyre, të zgjidhen dhe të zgjedhin në bordin e shkollës, të marrë pjesë në aktivitetet shkollore dhe jashtëshkollore, të ankohen dhe të propozojnë tek drejtori i shkollës, stafi i shkollës apo bordi i shkollës dhe të marrin një përgjigje jo më vonë se 30 ditë nga dorëzimi i ankesës.

Këshilli i Prindërve të Shkollës, Këshilli i Prindërve të Klasës dhe Shoqata e Prindërve janë struktura konsultative. Këshilli i Prindërve të Klasës krijohet brenda 20 ditëve nga fillimi i vitit shkollor me ndihmën e mësuesit kujdestar të klasës. Ai përbëhet nga 3-5 prindër dhe takohet çdo dy muaj. Këshilli i Prindërve të Shkollës krijohet brenda 30 ditëve nga fillimi i shkollës nën kujdesin e drejtorit të shkollës. Ai përbëhet nga 5-15 antarë dhe takohet një herë në çdo semestër, edhe pse më shpesh nëse është nevoja.

Këshilli i Prindërve bashkëpunon me drejtimin e shkollës për të siguruar progresin në arsim, bashkëpunon me Këshillat më të vegjël të Prindërve, siguron bashkëpunim më të ngushtë me familjet e nxënësve, komunitetin, qeverinë vendore, klientë dhe donatorë. Këshilli ndihmon, këshillon dhe propozon zgjidhje eficiente për demokratizimin e shkollës, për zhvillimin e vlerave morale, etike dhe kulturore. Përfaqësuesit e Këshillit marrin pjesë në analizën e punës së Këshillit Pedagogjik.

Shoqatat e Prindërve mund të krijohen me iniciativën e lirë të prindërve në nivel lokal apo në nivel kombëtar. Autoritetet e arsimit mbështesin dhe nxisin shoqatat e prindërve në të drejtat e tyre ligjore, i lejojnë të përdorin ambientet e shkollës për aktivitetet e tyre, ofrojnë mbështetje financiare dhe materiale, respektojnë të drejtën e tyre për informacion dhe akses.

Bordi i Shkollës është një strukturë e re në sistemin e arsimit në Shqipëri. Bordi supozohet të jetë pjesë në ngritjen e fondeve për shkollën, në marrjen e vendimeve dhe ndikimin në procesin e arsimit. Për shkak të keqkuptimeve dhe keqkonceptimeve mbi detyrat e Bordit, në 2007 u përshtat një Udhëzim i ri “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të shkollës.” (Ministria e Arsimit dhe Shkencës, 2007). Sipas Udhëzimit të ri, Bordi nuk ngrihet nga drejtori i shkollës por Drejtoria Arsimore Rajonale. Dispozitat Normative e përcaktuan rolin e drejtuesit të shkollës si anëtar dhe sekretar të Bordit, por sipas Udhëzimit të ri drejtori i shkollës nuk është më anëtar.

1.1.3 Çështje mbi pjesëmarrjen e prindërve

Pjesëmarrja e prindërve nuk është një çështje e studiuar mirë në Shqipëri. Sipas një studimi të kryer nga Qendra për Arsim Demokratik (CDE) dhe Unicef (2008), përfshirja e prindërve ka disa dobësi. Një prej tyre është niveli i ulët i ndërgjegjësimit të prindërve mbi rolin e tyre dhe detyrimet si edukatorë të fëmijëve të tyre dhe prirja për t’ia deleguar këtë rol shkollës. Një nga treguesit e pjesëmarrjes së kufizuar të prindërve është fakti që në takimet e shkollës marrin pjesë më pak se gjysma e tyre. Gjithashtu cilësia e pjesëmarrjes është e ulët, duke nënkuptuar pasivitet në vend të aktivizmit dhe të qenit proaktiv. Një tjetër dobësi është edukimi i mangët i mësuesve dhe drejtuesve të shkollës në lidhje me komunikimin dhe bashkëpunimin me prindërit. Gjithashtu ka një dobësi të dukshme të prindërve në lidhje me aftësitë për t’u vetëorganizuar në këshillat e prindërve.

Sipas gjetjeve të sondazhit të drejtorëve të shkollave të ndërmarrë nga Projekti “Përparimi i përfshirjes dhe cilësisë në arsim në Evropën Juglindore” 2008, mësuesit nuk janë të prirur t’iu kërkojnë prindërve të marrin pjesë në organizimin e aktiviteteve më tepër se një herë në muaj. Ata prirën t’i kërkojnë prindërve të përfshihen një herë në tre muaj ose një herë në semestër. Aktivitetet ku prindërit kërkohen të kontribuojnë më pak sipas drejtorëve të shkollave janë

ngritja e fondeve për shkollën, ndihma për prindërit e tjerë mbi edukimin e fëmijëve të tyre dhe ndihma në mësimdhënie.”

Sipas të dhënave nga fokus grupet me prindërit e nxënësve, të ndërmarra nga i njëjti Projekt, “ndërtimi i një shkolle ku të gjithë fëmijët të trajtohen në mënyrë të barabartë duhet të jetë prioritet. Këta prindër thonë se nuk janë pjesë e reformave në arsim, pasi nuk iu është marrë kurrë mendimi.” Prindërit, sidomos ata të përjashtuar nga ana sociale si minoritetet dhe të varfërit, nuk janë të ndërgjegjësuar për situatën e pjesëmarrjes së prindërve në shkollën e tyre. Sipas tyre, ata nuk kanë qenë aktivë pasi nuk iu është kërkuar kurrë të ndihmojnë, por edhe pasi janë të zënë me punë.” Sipas të dhënave nga grupet e fokusuar me prindër, prindërit në përgjithësi, sidomos minoritetet dhe nga grupet e varfra, nuk kanë një të kuptuar të plotë të pjesëmarrjes së prindërve në shkollë. Ata besojnë se është roli i shkollës për t’i përfshirë ata në jetën e shkollës dhe identifikojnë vetëm disa nga mënyrat e shumta se si mund të përfshihen dhe të kontribuojnë me burimet e tyre.

1.2 Metodologjia

Në këtë studim u përdor metoda e sondazhit, me anë të intervistave të drejtpërdrejta. Sondazhi u zbatua nga Ipsos Strategic Puls. Ai u parapri nga shqyrtimi dhe rishikimi i kontekstit në Shqipëri në lidhje me pjesëmarrjen e prindërve dhe legjislacionin që e rregullon atë. Gjithashtu, studimi u parapri edhe nga organizimi i disa fokus grupeve me prindër të grupeve të ndryshme si p.sh. prindër nga grupi i shumicës, prindër nga grupet vulnerabël.

1.2.1 Objektivat e studimit

Studimi kishte për objektiv zbulimin e qëndrimeve, pikëpamjeve të prindërve ndaj bashkëpunimit prindër-shkollë dhe përfshirjes së tyre në jetën e shkollës, si edhe marrëdhëniet e deritanishme midis shkollës dhe familjeve.

1.2.2 Kampioni

Popullata e studimit përbëhej nga :

- A) Prindër të nxënësve të shkollës fillore¹
- B) Prindër antarë të bordeve të shkollës ose të këshillave të prindërve në të njëjtën shkollë apo prindër antarë të shoqatës prind-mësues
- P) Drejtorë shkollash në secilën shkollë
- E) Prindër të përjashtuar në aspektin social²

¹ Për hir të shkurtimit, ky grupim i kampionit do të gjendet tani e tutje në raport me termin “prindër të zakonshëm” duke nënkuptuar shumicën e universit të prindërve, pra ata që *nuk* janë pjesë e përfaqësimit në strukturat e shkollës dhe që *nuk* janë të përjashtuar nga ana sociale.

² Me “prindër të përjashtuar në aspektin social” në këtë studim do të kuptohen prindër të cilët i përkasin kategorive të mëposhtme: Prindërit e fëmijëve që vijnë nga familje pa të ardhura të rregullta, nga familje me një prind, nga familje me një prind që punon jashtë vendit, nga familje ku të dy prindërit punojnë jashtë vendit, nga institucione të

Madhësia e kampionit paraqitet si më poshtë:

Kampioni i shkollave: 30 shkolla gjithsej

Kampioni A: 900 prindër gjithsej

Kampioni B: në çdo shkollë, një antar i bordit të shkollës dhe katër antarë të këshillit të prindërve u përzgjedhën për intervistë në mënyrë rastësore nga një listë e antarëve të bordit dhe këshillit në përfundim të vitit shkollor më të fundit, maj/qershor 2009. Nëse shkolla nuk kishte një këshill prindërisht, atëherë u përzgjedhën katër prindër nga shoqata prindër-mësues. Nëse në shkollë nuk kishte as këshill prindërisht, as shoqatë prindër-mësues, atëherë u përzgjedh vetëm një antar nga bordi i prindërve të shkollës.

Në rast se nga procedura e listës së vitit më të fundit shkollor nuk arrihej të lokalizoheshin subjektet, pasi p.sh. ishin larguar nga zona, atëherë zëvendësimi bëhej nga prindër të bordit apo këshillit të këtij viti akademik.

Këta përfaqësues të prindërve u përzgjedhën gjithashtu nga dy shkolla në kampionin E.

Kampioni P: drejtorët e secilës nga 30 shkollat e vendit, plus dy drejtorët nga dy shkollat me prindër të përjashtuar nga ana sociale (32 drejtorë në të gjithë vendin)

Kampioni E: dy kampione me 30 prindër të përjashtuar nga ana sociale në dy shkolla (gjithsej 60 prindër të përjashtuar nga ana sociale)

Tabela 1. Shpërndarja e kampionit të shkollave sipas variablit të rajonit gjeografik dhe përkatësisë urbane/rurale

<i>Rajonet gjeografike</i>	<i>Shkollat</i>		<i>Sondazhi me drejtorët e shkollave</i>			<i>Sondazhi me prindërit</i>		
			<i>Kampioni</i>	<i>Urban</i>	<i>Rural</i>	<i>Kampioni</i>	<i>Urban</i>	<i>Rural</i>
Veri	445	30%	89	77	12	8	4	4
Qendër	324	22%	66	54	12	7	4	3
Jug	569	38%	116	94	22	8	4	4
Tiranë	146	10%	29	9	20	7	3	4
Total Shqipëri	1484	100%	300	234	66	30	15	15

Tabela 2. Kampioni i prindërve i peshuar sipas zonave gjeografike të studimit

<i>Rajonet gjeografike</i>	<i>Zona urbane</i>	<i>Zona rurale</i>	<i>Total</i>
Veri	84	141	225
Qendër	139	112	251
Jug	148	205	353
Tiranë	212	82	294
Total Shqipëri	583	540	1123

përkujdesjes (shtëpi të fëmijës), që i përkasin minoriteteve etnike, janë Romë apo kanë nevoja të veçanta të të nxënit.

1.2.3 Procedurat e kampionimit

Studimi respektoi procedurat e mëposhtme të kampionimit :

Universi i këtij studimi ishte lista e shkollave drejtorët e të cilave morën pjesë në sondazhin e mëparshëm. Lloji i kampionimit ishte kampionim i rastësishëm i shtresëzuar. Shtresëzimi u krye sipas rajoneve gjeografike përkatëse (si në studimin e mëparshëm i cili kishte për subjekt drejtorët e shkollave) dhe sipas përkatësisë urbane/rurale (kampion i shtresëzuar dy dimensional). Përcaktimi i numrit të kampionit për çdo shtresë u bë në mënyrë që të përmbushej formula $30/(2*\text{numrin e rajoneve gjeografike})$. Metoda e përzgjedhjes ishte përzgjedhja rastësore (proporcionale me numrin e nxënësve në shkollë). U përdor metoda e Lahirie (kumulative lineare) e përzgjedhjes së kampionit.

Metoda e përzgjedhjes së respondentit në kampionin A të prindërve përmbante identifikimin e zonës që mbulon shkolla e përzgjedhur. Më pas, u zgjodhën banesat në mënyrë rastësore duke përdorur disa pikënisje për çdo shkollë. Nga pikënisja, intervistuesi vizitoi një banesë pas tjetrës derisa të gjente atë që kishte një fëmijë që:

- ndjek një nga shkollat në kampion
- është nga mosha 8 deri në 13 vjeç, pra ka mbushur 8 vjeç dhe nuk ka mbushur ende 14.

Respondenti në intervistë ishte nëna e fëmijës ose babai i tij. Në raste të veçanta, janë intervistuar kujdestarët kryesorë të familjes. Intervista ishte një intervistë e strukturuar ballë për ballë e bazuar në instrumentin e sondazhit dhe e përkthyer në gjuhën shqipe.

Në zonat ku popullësia Rome është më e shpeshtë, intervistat me grupin e prindërve të përjashtuar nga ana sociale u kryen nga një ekip që përfshinte edhe një person nga komuniteti Rom.

Për kampionin B, mënyra e përzgjedhjes u krye nëpërmjet shkollës, e cila u kontaktua dhe u sigurua lista e prindërve që ishin antarë të bordeve apo këshilleve të prindërve. Intervista u krye ballë për ballë edhe me respondentët e këtij kampioni.

Kampioni P i drejtorëve të shkollave u përzgjedh duke kontaktuar drejtorët e secilës shkollë të përzgjedhur dhe duke kryer intervistën ballë për ballë.

Dy kampionet e prindërve të përjashtuar nga ana sociale do të përzgjidhen nga dy zona, 30 për çdo kampion në lagjet ku ata janë më të përqëndruar.

1.2.4 Analiza e të dhënave

Analiza e të dhënave në këtë raport përmban gjetjet për kampionin e prindërve, por edhe ato për kampionin e drejtorëve të shkollave. Kjo do të thotë se të dhënat për drejtorët janë shkrirë në nivel shkolle, pra për çdo prind, së bashku me të dhënat e tij, janë vënë edhe të dhënat e drejtorit të shkollës që ndjek fëmija. Megjithatë, për hir të objektivit të sondazhit, i cili fokusohet tek prindërit, rezultatet më poshtë janë paraqitur duke iu referuar prindërve.

Në raport paraqiten ato gjetje të cilat janë statistikisht domethënëse.

II Gjetjet

2.1 Një vështrim mbi variablat e përgjithshëm

Duket se përfshirja ose mospërfshirja e prindërve në jetën e shkollës lidhet në mënyrë domethënëse me aspekte të tjera të jetës shkollore të fëmijës si p.sh. kënaqësinë në shkollë apo rezultatet e fëmijës në shkollë.³ Në përgjithësi, fëmijët e prindërve të zakonshëm e pëlqejnë vajtjen në shkollë ose e kanë me shumë qejf atë. Megjithatë, fëmijët e prindërve që përfaqësohen në struktura të shkollës priren ta duan shkollën më shumë se fëmijët e prindërve të zakonshëm. Nga ana tjetër, fëmijët e prindërve të përjashtuar nga ana sociale priren të mos e pëlqejnë shkollën krahasuar me fëmijët e prindërve të tjerë. Ky rezultat na shtyn të mendojmë se fëmijët janë më të kënaqur me shkollën nëse prindërit e tyre janë të përfshirë në jetën e saj.

Gjetjet tregojnë se ka një lidhje domethënëse ndërmjet rezultateve të fëmijës në shkollë dhe faktit nëse prindërit e tyre janë të përfshirë apo jo në jetën e shkollës. Kështu, rezultatet e fëmijëve të prindërve të përjashtuar nga ana sociale janë kryesisht mesatare ose nën mesataren, krahasuar me rezultatet e fëmijëve të prindërve të zakonshëm të cilat janë kryesisht mbi mesataren. Për më tepër, fëmijët e prindërve që janë të përfshirë në shkollë, kanë rezultate më të mira se mesatarja ose të shkëlqyera, krahasuar me fëmijët e prindërve të zakonshëm ose atyre të përjashtuar nga ana sociale. Pëlqimi i shkollës dhe rezultatet e larta duket se korrelojnë në mënyrë pozitive dhe domethënëse (koeficienti i korrelacionit 0.57).

Sa më të larta rezultatet e fëmijës në shkollë, aq më tepër gjasa ka që numri i librave në shtëpinë e tij të jetë i lartë. Gjysma e fëmijëve të cilët kanë rezultate të dobta, nuk kanë *asnjë* libër në shtëpi. Numri më i madh i librave në shtëpi haset më shpesh tek prindërit që përfshihen në jetën e shkollës, krahasuar me prindërit e tjerë. Pjesa më e madhe e prindërve të përjashtuar nga ana sociale pranojnë se nuk kanë asnjë libër në shtëpi.

Prindërit që përfshihen në jetën e shkollës por edhe prindërit e zakonshëm kanë shpresa dhe aspirata më optimiste për arsimimin e fëmijëve të tyre. Pjesa më e madhe e tyre presin që fëmija të arsimohet në universitet dhe më tej. Ndërkohë, pjesa më e madhe e prindërve të përjashtuar nga ana sociale presin që fëmijët e tyre të marrin arsim të mesëm (më tepër profesional sesa të përgjithshëm), pra janë të prirur nga dhënia e një zanati fëmijës. Gati një e treta e këtyre prindërve mendojnë se fëmija e tyre do të përmbushë vetëm arsimin e detyrueshëm. Aspirata për të parë fëmijët e tyre në universitet dhe më tej është më e shpeshtë tek nënat që kanë përfunduar të paktën arsimin e mesëm krahasuar me ato që kanë përfunduar vetëm të detyrueshmin. Aspiratat pozitive bëhen më të shpeshta, me rritjen e nivelit të arsimimit të nënës.

Pjesa më e madhe e nënave kanë kryer të paktën arsimin e mesëm të përgjithshëm. Megjithatë, kjo nuk është e vërtetë për nënat nga grupet e përjashtuara nga ana sociale, pjesa më e madhe e të cilave ka shkuar deri në nivelin e arsimit të detyrueshëm, nga të cilat, vetëm gjysma e kanë përfunduar. Ndërkohë, prindërit që përfaqësohen në jetën e shkollës kanë më shumë gjasa të jenë

³ Fakti që variablat lidhen në mënyrë domethënëse statistikisht nuk do të thotë se midis tyre ka një lidhje shkak-pasojë.

me arsim universitar ose pasuniversitar krahasuar me prindërit që nuk përfaqësohen. Sa më i lartë niveli i arsimimit të nënës, aq më e shpeshtë është prirja për të marrë pjesë në trainime, seminare apo shkolla verore nëse do të jepej mundësia.

Ka një dallim domethënës midis vajzave dhe djemve për sa i takon kënaqësisë nga shkolla. Djemtë kryesisht thjesht e *pëlqejnë* vajtjen në shkollë, ndërkohë që vajzat janë gati dy herë më të prirura se djemtë për ta *pasur shumë qejf* shkollën. Ndërkohë, janë më tepër vajzat sesa djemtë që shkëlqejnë në rezultatet në mësim, kundrejt rezultateve të djemve të cilat janë mesatare apo nën mesataren më shpesh se ato të vajzave.

Është interesant fakti që mirëqenia në shtëpi korrelohet në mënyrë pozitive me faktorë si pëlqimi i shkollës nga ana e fëmijës (koeficient 0.23) dhe arritjet e tij në shkollë (koeficient 0.32), numrin e librave në shtëpi (koeficient 0.37) dhe nivelin arsimor të nënës (koeficient 0.41). Kësisoj, sa më i lartë niveli i mirëqenies, aq më shumë gjasa ka që nëna e fëmijës të ketë nivel të lartë arsimit, fëmija ta pëlqejë shkollën, të ketë rezultate të larta dhe të ketë numër të madh librash në shtëpi.

2.2 Dimensionet e pjesëmarrjes

2.2.1 Takimet me prindër në shkollë


Ftesat nga ana e shkollës për të marrë pjesë në takimet e klasës janë më të rralla për prindërit Romë dhe prindërit e përjashtuar nga aspekti social. Gati gjysma e prindërve Romë deklarojnë se ftesa për takimet me prindër ka ardhur 3 ose më pak herë gjatë vitit të fundit. Ndërkohë, ftesa duket se është më e shpeshtë për prindërit përfaqësues në shkollë. Ftesat më të shpeshta për takimet me prindër janë në Tiranë, ndërkohë që nuk ka ndonjë dallim ndërmjet zonave urbane dhe rurale. Drejtorët e shkollave në studim japin një numër mesatar të ftesave më të lartë se ai që deklarojnë prindërit.

Prindërit që priren të pranojnë ftesën e shkollës për takime janë më shpesh prindër që banojnë në zona rurale si edhe ata që i përkasin një shtrese të zakonshme të popullësisë e cila nuk është e përjashtuar nga aspekti social. Ndërkohë, drejtorët e shkollave japin një shifër më të ulët të pranimit të ftesave nga prindërit.

Është interesante që prindërit Romë dhe prindërit e përjashtuar nga ana sociale në përgjithësi nuk janë shumë të sigurtë nëse shkolla *duhet* t'i thërrasë prindërit në takime të tilla. Prindërit në Tiranë (95.2%) janë të sigurtë se shkolla *duhet* t'i thërrasë prindërit në takime. Janë kryesisht prindërit të cilët përfaqësohen në shkollë që mendojnë se shkolla *duhet* t'i thërrasë patjetër prindërit në këto takime.

Prindërit e grupit të përjashtuar nga ana sociale janë të prirur të mendojnë se s'janë të aftë për të përdorur në mënyrën më të mirë këto takime.

Grafik 1. Në lidhje me mbledhjet me prindërit, (takime klase, në grup apo individuale), a ndihet të paktën njëri në familjen tuaj i aftë dhe kompetent për të shfrytëzuar për mirë këtë lloj takimi? (në përqindje)



Përgjatë realizimit të fokus grupeve , prindërit dhanë mendimin se në takimet me prindër atyre iu jepej informacion por ky jo i mjaftueshëm. Gjithashtu, ata pohonin se shkolla i informonte në fillim të vitit shkollor për planet dhe aktivitetet e saj, por më vonë, thjesht iu kërkonte kontributin e tyre dhe i informonte mbi sjelljen apo notat e fëmijës.

2.2.2 Informacioni i shkruar për prindërit

Prindërit u pyetën se sa shpesh merrnin informacion mbi mbarëvajtjen e fëmijës si: vlerësim të shkruar, listë notash, raporte përfundimtare, dhe/ose raporte të ngjashme nga shkolla. Duket se ata prindër që e kanë marrë këtë lloj informacioni të shkruar mbi dy herë në vit i përkasin grupit të prindërve të zakonshëm dhe, më shpesh, prindërve të cilët përfaqësohen në strukturat e shkollës. Ndërkohë, pjesa më e madhe e prindërve të përjashtuar nga ana sociale (68.5%) i kanë marrë informacione të tilla vetëm një herë përgjatë vitit të kaluar. Vihet re një dallim në shpeshësinë e këtij informacioni nga njëra shkollë në tjetrën. Në disa shkolla, është e lartë përqindja e prindërve (më shumë se 60%) të cilët thonë që nuk kanë marrë *kurrë* informacion të shkruar për fëmijën.

Prindërit të cilët i përkasin strukturave të shkollës kanë më shumë gjasa të lexojnë informacionin e shkruar të dërguar nga shkolla, krahasuar me prindërit e zakonshëm ose prindërit e përjashtuar nga ana sociale. Duket se prindërit femra, prindërit nga zonat rurale dhe ata nga zonat veriore të vendit janë më të prirur për të lexuar këto informacione që dërgon shkolla.

Prindërit që i përkasin grupit të përjashtuar nga shoqëria, nuk janë shumë të sigurtë nëse shkolla duhet t’iu dërgojë atyre informacion të shkruar mbi mbarëvajtjen e fëmijës. Asnjë prind i këtij grupi nuk e ka lexuar informacionin të gjitha herët që u është dërguar. Edhe pse pjesa më e madhe e tyre (62%) mendojnë se është detyra e prindit që ta lexojë këtë informacion apo gati

83% mendojnë se ndihmon tek fëmija, 40% e tyre nuk ndjehen në gjendje për ta lexuar këtë informacion dhe për ta përdorur atë.

Drejtorët e shkollave deklarojnë se informacioni i shkruar i vihet në dispozicion prindërve më shpesh nga ç' deklarojnë vetë ata.

2.2.3 Mbështetja për të nxënë

Tridhjetë përqind e prindërve të përjashtuar nga ana sociale nuk ndjehen të aftë për të ndihmuar fëmijët e tyre në detyrat e shtëpisë. Ndërkohë, është interesante që prindërit e këtij grupi të cilët përfaqësohen në strukturat e shkollës nuk e përjetojnë këtë gjë, por mendojnë se janë të aftë për të ndihmuar fëmijët.

Janë prindërit e zakonshëm dhe prindërit që janë pjesë e strukturave të shkollës të cilët kryesisht mendojnë se ndihma nga ana e prindërve për detyrat e shtëpisë do të ndihmonte fëmijën. Ndërkohë, prindërit e përjashtuar nga ana sociale nuk dëshmojnë të njëjtën shkallë sigurie. Dyzet e gjashtë përqind e tyre mendojnë se *ndoshta* do të ndihmonte.

Janë *nënat* ato që në pjesën më të madhe të rasteve ndihmojnë fëmijët me detyrat e shtëpisë pavarësisht nga grupimi ku bëjnë pjesë. Baballarët nga grupi i prindërve të zakonshëm dhe prindërve që përfshihen në shkollë janë gati 8 herë më pak të prirur për t'u përfshirë në dhënien e ndihmës. Baballarët nga grupet e përjashtuara nga ana sociale *nuk* i ndihmojnë aspak fëmijët e tyre.

Nënat në jug të vendit, nënat në Tiranë dhe nënat nga grupe jo të përjashtuara, janë më të prirura se nënat në zonat e tjera për të ofruar ndihmë me detyrat e shtëpisë.

Njëzet e pesë përqind e fëmijëve Romë *nuk* marrin ndihmë nga askush për detyrat e shtëpisë. Është interesante që 27% e fëmijëve Romë ndihmohen për detyrat nga dikush tjetër që nuk është prindi. Baballarët Romë *nuk* përfshihen aspak në ndihmën për detyrat e shtëpisë.

2.2.4 Ndihma vullnetare

Prindërit që përfaqësohen në strukturat e shkollës janë ftuar më shpesh sesa prindërit e tjerë për të ndihmuar në përmirësimin e infrastrukturës së shkollës. Gjashtëdhjetë përqind e prindërve Romë nuk janë ftuar asnjëherë për të ndihmuar në këtë drejtim, kundrejt 31% të prindërve që i përkasin shumicës së popullësisë. Megjithatë, 17% e këtyre prindërve nuk kanë ofruar asnjëherë ndihmë shkollës, edhe në ato raste kur iu është kërkuar. Prindërit që përfaqësohen në strukturat e shkollës kanë qenë më të prirur se prindërit e tjerë për t'u përgjigjur ftesës së shkollës për ndihmë.

Pjesa më e madhe e prindërve nuk ishin thirrur *kurrë* për të ndihmuar në orët e mësimëve, për të treguar ndonjë histori, për të folur mbi profesionin e tyre, për të luajtur në ndonjë vegël muzikore apo për të ndihmuar mësuesit në procesin e mësimdhënies. Megjithatë, ishte interesant fakti që gati një e treta e prindërve Romë janë ftuar 2-3 herë për të ndihmuar. Gjithashtu, duket se ftesa më të shpeshta (më shumë se tre herë në vit) kanë marrë prindërit që përfaqësohen në strukturat e shkollës, duke i krahasuar me prindërit e tjerë.

Gjithashtu, pjesa më e madhe e prindërve nuk janë thirrur për të ndihmuar në bibliotekë apo ambiente të tjera si p.sh. mirëmbajtjen e oborrit. Prindërit e përjashtuar nga ana sociale kanë qenë më të prirur se të tjerët për të ndihmuar në rastet e ftesave të tilla. Megjithatë, ata nuk janë të bindur në të njëjtën masë si grupet e tjera të prindërve se kjo është diçka që shkolla *duhet* ta bëjë patjetër.


Ndërkohë që prindërit që janë përfaqësues në strukturat e shkollës apo prindërit e zakonshëm ndihen të sigurtë se ndihma vullnetare është e nevojshme për të ndihmuar fëmijët e tyre, vetëm 20.4% e prindërve të përjashtuar nga ana sociale janë të sigurtë për këtë.

2.2.5 Pjesëmarrja në vendimmarrje

Më shumë se gjysmës e të gjithë prindërve në kampion nuk i është kërkuar kurrë mendim në lidhje me menaxhimin e fondeve të shkollës. Nëse do të shihnim brenda grupeve të veçanta, është interesant fakti që 28% e prindërve të përjashtuar nga ana sociale janë pyetur të paktën 2 herë në lidhje me këto çështje gjatë vitit të kaluar dhe 15% të tyre iu është kërkuar mendim një herë gjatë vitit. Janë kryesisht prindërit që përfaqësohen në strukturat e shkollës që thonë se iu është kërkuar mendim më shumë se 3 herë, krahasuar me prindërit e zakonshëm ose prindërit e përjashtuar nga ana sociale.

Prindërit të cilët janë të përjashtuar nga ana sociale nuk janë të prirur t'i përgjigjen këtyre ftesave për të dhënë mendim, çdo herë. Ndërkohë që janë më shumë prindërit e zakonshëm, sidomos prindërit të cilët janë të përfaqësuar në strukturat e shkollës të cilët i janë përgjigjur kësaj ftese të shkollës.

Grafik 2. Sa herë ka kërkuar shkolla mendimin tuaj në vitin e kaluar (personalisht apo familjarisht) në lidhje me çështje si përmbajtja e lëndëve, teksteve, vlerësimi i mësuesve etj? (në përqindje)



Në ato raste që është kërkuar mendim, përgjithësisht shkolla e ka marrë parasysh në një shkallë të gjerë mendimin e prindërve në lidhje me menaxhimin e fondeve. Megjithatë, shkolla ka marrë parasysh plotësisht mendimin e prindërve të cilët janë përfaqësues të strukturave të shkollës ose prindër të zakonshëm, krahasuar me prindërit e përjashtuar nga ana sociale. Është interesante që vetë prindërit e përjashtuar nga ana sociale nuk janë dakord që shkolla t'iu merrte mendim në lidhje me këto çështje.

Prindërve, si atyre të zakonshëm edhe atyre të përjashtuar nga ana sociale, përgjithësisht nuk iu është marrë mendim në lidhje me aktivitete jashtëshkollore. Megjithatë, prindërit e zakonshëm janë më të prirur se ata të përjashtuar nga ana sociale për t'iu përgjigjur kësaj kërkesë të shkollës. Vetëm 20.5% e këtyre prindërve janë të sigurtë që shkolla duhet t'i kërkojë mendim prindërve në lidhje me këto aktivitete.

Të pyetur nëse shkolla ka marrë parasysh opinionin e tyre si prindër për organizimin e aktiviteteve një pjesë e prindërve të zakonshëm (44%) dhe një pjesë e prindërve të përjashtuar nga ana sociale (45%) thonë se kjo nuk ka ndodhur kurrë. Krahasuar me prindërit që përfaqësohen në jetën e shkollës, këto përqindje janë më të larta. Prindërit e zakonshëm dhe prindërit që janë përfaqësues në strukturat e shkollës priren t'i përgjigjen kësaj kërkesë të shkollës në më të shumtën e rasteve ose në të gjitha rastet. Ndërkohë që në radhët e prindërve që janë të përjashtuar nga ana sociale nuk ka që t'i jenë përgjigjur çdo herë kërkesave të tilla të shkollës. Një faktor që mund të ketë lidhje me këtë rezultat është se shkolla asnjëherë nuk i ka marrë parasysh krejtësisht opinionet e këtyre prindërve.

Këto gjetje janë përgjithësisht në përputhje edhe me të dhënat nga grupet e fokusuara me prindër të organizuara në Projekt. Në këto grupe, prindërit përmendën si përfshirje të tyre: kontributin me para në fillim të vitit shkollor dhe ndihmë për të rregulluar mjedise të shkollës. Ndërkohë, ata u shprehën se thjesht informoheshin për vendime të tjera, por nuk ishin pjesë e tyre.

Të pyetur nëse ata vetë, pa ndihmën e prindërve të tjerë, janë përpjekur ndonjëherë të ndikojnë diçka si p.sh. të ankohen për ndonjë notë apo për ndonjë fëmijë tjetër, pjesa më e madhe e prindërve thonë se nuk e kanë bërë kurrë: 73.4% e prindërve të zakonshëm, 80.5% e prindërve që përfaqësohen në strukturat e shkollës, ndërkohë që tek prindërit e përjashtuar nga ana sociale përqindja ishte më e lartë akoma (93%). Është interesante të shohësh se edhe prindërit përfaqësues në struktura nuk e kanë marrë ndonjëherë iniciativën për të ndikuar diçka në shkollë. Duket se është më e shpeshtë tek prindërit e zakonshëm që të marrin nisma të tilla individuale, krahasuar me prindërit e tjerë.


Ankesa kryesore e prindërve të cilët janë përpjekur të ndikojnë diçka ka qenë nota e fëmijës. Janë më shumë nënat që janë ankuar për notën, për arsye të sjelljes së një fëmije tjetër dhe të qëndrimit të mësueses/it ndaj fëmijës. Baballarët duket se janë shprehur më tepër në lidhje me orarin e mësimin. Rezultatet tregojnë se nënat kanë më tepër rezultate se baballarët në arritjen e asaj që donin.

Pjesa dërrmuese e prindërve nuk është përpjekur asnjëherë që të organizohen së bashku me prindërit e tjerë për të ndikuar në shkollë. Duket se prindërit e përjashtuar nga ana sociale janë angazhuar më shpesh së bashku për të ndikuar diçka në shkollë. Njëzet e pesë përqind e tyre janë

grupuar të paktën një herë për të ndikuar diçka në shkollë. Pavarësisht nga kjo, ata mendojnë se e përmbushën vetëm në një shkallë të ulët synimin e tyre .

Prindërit që përfaqësohen në strukturat e shkollës janë më të sigurtë se kanë aftësi për të marrë pjesë në vendimmarrjen e shkollës. Në krahasim me ta, prindërit e zakonshëm që e mendojnë kështu janë më pak, ndërkohë që prindërit që i përkasin grupit të përjashtuar përgjithësisht nuk ndjehen të sigurtë për aftësinë e tyre në vendimmarrje. Gati gjysma e këtyre të fundit mendojnë se nuk është detyra e tyre të marrin pjesë në këto vendime. Këto gjetje janë në përputhje edhe me të dhënat nga fokus grupet me prindër, ku këta të fundit e shihnin veten përgjithësisht si të panevojshëm në vendimmarrje. Sipas tyre, vetëm prindërve me nivel intelektual ose arsim të lartë duhet t’iu dëgjohej zëri.

Grafik 3. A u munduat të ndikonit diçka bashkë me prindër të tjerë (pa ua kërkuar shkolla)?
(në përqindje)



2.2.6 Roli i prindërve në shkollë (përfaqësimi në struktura)

Gjashtëdhjetë përqind e prindërve Romë thonë se nuk iu është kërkuar *asnjëherë* në tre vitet e fundit që të bëhen pjesë e këshillit të klasës ose të shkollës, ndërkohë që 37% e tyre thonë se ju është kërkuar vetëm një herë të jenë pjesë e këshillit të klasës.

Prindërit Romë mendojnë se nuk janë të aftë për të bërë rol të tillë përfaqësues në strukturat e shkollës më shpesh krahasuar me prindërit e tjerë. Nga ana tjetër, prindërit që janë përfaqësues në këto struktura ndjehen të aftë për këtë rol më shpesh se pjesa tjetër e prindërve. Këta të fundit besojnë se është detyrë e prindit që të marrë role të tilla, dhe e besojnë këtë më shpesh sesa prindërit e tjerë, duke qenë të sigurtë se kjo do të ndihmonte fëmijën e tyre.

2.2.7 Bashkëpunimi shkollë – komunitet

Ndihma e shkollës për familjet e komunitetit mbi çështje të ndryshme si p.sh. mbi shëndetin komunitar, strehim, çështje sociale, ka qenë shumë e rrallë dhe kjo nuk ndryshon sipas zonave të ndryshme të vendit. Mbi 90% e prindërve thonë se shkolla nuk jua ka ofruar *kurrë* këtë ndihmë.

Edhe në ato raste që kanë ndihmuar, ka qenë kryesisht për ndërtimin ose rinovimin e shtëpisë dhe këtë në zonat rurale.


2.3 Faktorë parashikues dhe ndërmjetësues

2.3.1 Qëndrimet ndaj bashkëpunimit shkollë - familje

Një pjesë e prindërve (gati 57%) mendojnë se ata janë të interesuar për të marrë pjesë në aktivitetet e shkollës. Shkalla më e lartë e optimizmit në lidhje me këtë gjendet mes prindërve të zonës së veriut të vendit. Gjithashtu, prindërit mendojnë se ata kanë kohë për t'u informuar mbi çështjet e shkollës, edhe pse nuk është një shumicë e konsiderueshme. Vetëm prindërit në Shqipërinë e mesme janë më të prirur të mendojnë se prindërit nuk kanë kohë, ndoshta sepse këtu hyjnë disa qytete të mëdha të vendit si Durrësi dhe Elbasani.

Pjesa më e madhe e prindërve mendojnë se ata dinë të komunikojnë me mësuesit. Pjesa më e madhe e prindërve nuk mendojnë se mësuesit nuk janë të interesuar të komunikojnë me prindërit. Megjithatë, një pjesë e mirë e tyre mendojnë se mësuesit janë shumë të ngarkuar me punë dhe kjo i pengon të komunikojnë me prindërit. Kryesisht prindërit mendojnë se mësuesit i kanë kapacitetet të komunikojnë me të gjithë prindërit, edhe pse ka një dallim ndërmjet atyre që banojnë në zona urbane dhe atyre në zona rurale. Prindërit e zonave rurale mendojnë se mësuesit mund të komunikojnë me të gjithë prindërit më shpesh sesa ata në zonat urbane, ndoshta e lidhur kjo me numrin e vogël të nxënësve në klasë në shkollat e zonave rurale. Pjesa më e madhe e prindërve nuk mendojnë se ka konflikt mes tyre dhe shkollës.

Grafik 4. Duke parë mbrapa në kohë format e ndryshme të pjesëmarrjes në jetën shkollë, sa dakord do të ishit me fjalitë e mëposhtme? (në përqindje)



2.3.2 Perceptimi mbi hapjen e shkollës

Vetëm 26% e prindërve Romë perceptojnë se sjellja e mësuesve është tërësisht me respekt ndaj tyre, krahasuar me 40% të prindërve të tjerë që mendojnë të njëjtën gjë. Gjithsesi, pjesa më e madhe e prindërve kryesisht mendojnë se mësuesit i trajtojnë me respekt. Vetëm 7% e prindërve Romë bien plotësisht dakord që mund të flasin lirshëm me mësuesit për fëmijën e tyre, krahasuar me 45% të prindërve të tjerë. Sërish, pjesa më e madhe e prindërve kanë opinion pozitiv në lidhje me këtë çështje, pra mund të flasin lirshëm me mësuesit për fëmijët e tyre.

Kryesisht, prindërit nuk e kanë takuar psikologun e shkollës së tyre ose e kanë takuar vetëm një herë. Janë prindërit në zonat urbane që e kanë takuar më shpesh krahasuar me ata në zonat rurale. Një pjesë e mirë e prindërve pranojnë se të paktën një antar i familjes së tyre gjendet shpesh në mjediset e shkollës. Kjo nuk është e vlefshme për prindërit Romë, vetëm 27% e tyre janë plotësisht dakord me këtë, kundrejt 55% e prindërve të tjerë.

Prindërit kryesisht mendojnë se nëse do t'i thoshin diçka mësuesit të fëmijës së tyre në lidhje me fëmijën e tyre, mësuesit do t'i kuptonin. Ndërkohë kjo është më e shpeshtë tek prindërit në zonat urbane se ata në zonat rurale dhe më e rrallë tek prindërit Romë (vetëm 23% e tyre kundrejt 61% të prindërve të tjerë). Sërish, janë prindërit që janë përfaqësues në strukturat e shkollës të cilët janë më shumë dakord me një pohim të tillë.

Prindërit në zonat rurale mendojnë se është e vështirë të takohesh me drejtorin e shkollës më rrallë sesa prindërit në zonat urbane, gjë që mund të lidhet me mundësinë më të madhe që kanë stafi i shkollës për t'u takuar me prindërit ndoshta për shkak të numrit më të vogël të nxënësve në shkollat rurale.

Përgjithësisht, prindërit janë dakord që është e lehtë të flasësh me prindërit e tjerë për probleme të caktuara. Gjithsesi, prindërit Romë që mendojnë kështu janë më pak se prindërit e tjerë. Prindërit e përjashtuar nga ana sociale të cilët bien plotësisht dakord me këtë gjë, janë në mënyrë domethënëse më pak sesa prindërit e tjerë.

2.3.3 Romët

Pjesa dërrmuese e fëmijëve të prindërve Romë në studim kuptojnë gjuhën kryesore me të cilën mësohet në shkollën e tyre. Për pjesën më të madhe të këtyre prindërve, është *më e lehtë* për fëmijët e tyre që të jenë në shkollë sesa për fëmijët e tjerë.

Dyzet e tre përqind e prindërve Romë mendojnë se për fëmijët e tyre është më e vështirë të mësojnë në shtëpi, pasi sipas tyre “nuk ka kush i mëson, pasi ata s'i mësojnë dot.” Vetëm 15% e prindërve Romë thonë se fëmija e tyre ka marrë ndihmë të veçantë nga shkolla si fëmijë Rom.

Pesëdhjetë e katër përqind e prindërve Romë mendojnë se shkolla bën mjaftueshëm për fëmijën e tyre, por 46% e tyre nuk janë dakord me këtë. Është 80% e prindërve Romë që mendon se mund të bëhet më tepër nga ana e shkollës për të ndihmuar fëmijët e tyre. Edhe përgjatë fokus grupeve prindërit Romë janë shprehur se mësues të caktuar nuk kanë dëshirë të punojnë me “njerëz si ata” dhe u shprehën se shkolla duhet të jetë e hapur për të gjithë prindërit.

Në 65% të shkollave ku ka komunitet Rom, asnjë punonjës i shkollës nuk pjesë e këtij komuniteti, ndërkohë që vetëm në 35% të shkollave ka të paktën një punonjës nga komuniteti Rom.

2.3.4 Përfaqësuesit e prindërve në strukturat e shkollës

Perceptimi për përfaqësuesit e prindërve në strukturat e shkollës

Përgjithësisht, prindërit i njohin përfaqësuesit e tyre në strukturat e shkollës dhe pranojnë se këta përfaqësues i trajtojnë prindërit me respekt dhe se mund të flasim lirshëm me ta nëse kanë ndonjë problem. Gjithsesi, prindërit e përjashtuar nga ana sociale, sidomos ata Romë, janë më pak të prirur se prindërit e tjerë për ta pranuar këtë. Më shumë se një e treta e prindërve mendojnë se prindërit përfaqësues nuk janë aktivë, kundrejt më shumë se gjysmës që mendojnë se janë. Më shumë se gjysma e prindërve mendojnë se prindërit përfaqësues nuk takohen me ta në mënyrë të shpeshtë. Pak më shumë se gjysma mendojnë se këta përfaqësues mbrojnë në mënyrë efektive interesat e tyre si prindër.

Perceptimet e përfaqësuesve të prindërve në strukturat e shkollës

Gjashtëdhjetë e dy përqind e prindërve përfaqësues pohojnë se janë zgjedhur nga vetë prindërit e shkollës, 24% thonë se iu kërkua nga mësuesi i klasës dhe gati 10% iu kërkua nga drejtori i shkollës. Njohja më e mirë e shkollës, ngritja e problemeve që shqetësojnë prindërit, përfitimi direkt për fëmijën e tij, dëshira për të ndryshuar diçka të veçantë në lidhje me fëmijën e tij, dëshira për të ndryshuar shkollën për të gjithë fëmijët, sepse u bindën nga të tjerët dhe fakti që prindërit e tjerë dëshironin që ai t'i përfaqësonte ishin arsye më të rëndësishme që i bënë prindërit të bëheshin pjesë e këtyre strukturave.

Pjesa më e madhe e prindërve përfaqësues kanë kontribuar *pak ose aspak* në fusha si menaxhimi financiar i shkollës dhe çështje arsimore si përmbajtja e teksteve, lëndëve, zgjedhja dhe vlerësimi i mësuesve, ngarkesa e nxënësve, etj., çështje të shëndetit dhe sigurisë, çështje të dhunës, përjashtimeve apo disiplinës, apo në menaxhimin e përgjithshëm të shkollës. Fusha ku ata duket se kanë kontribuar më tepër se në fushat e mësipërme janë aktivitetet jashtëshkollore dhe organizimet e aktiviteteve të shkollës.

Prindërit përfaqësues mendojnë se prindërit e tjerë nuk kanë besim se ata mund të bëjnë shumë në rolin që kanë, se besojnë që ata po e bëjnë vetëm për të mirën e fëmijës së tyre, vetëm për t'u dukur, se mund të hyj në punë vetëm kur bëhet fjalë për fëmijën e tyre. Gjithsesi, 64% e tyre mendojnë se prindërit e tjerë i shohin si përfaqësues efektivë dhe i mbështesin. Kjo gjetje kontradiktore me sa më sipër mund të vijë nga fakti se 91% e këtyre prindërve përfaqësues *nuk* janë të sigurtë se si perceptohen nga prindërit e tjerë.

Tetëdhjetë e tetë përqind e prindërve përfaqësues mendojnë se administrata e shkollës *nuk* është e interesuar për kontributin e tyre dhe se i duan vetëm sa për të mbështetur idetë e tyre. 85% pohojnë se administrata ua dëgjon idetë, por nuk i merr parasysh më vonë. Megjithatë, 80% pohojnë se administrata përpiket t'i kuptojë dhe përgjithësisht i merr parasysh pikëpamjet e tyre.

Vetëm gjysma e prindërve përfaqësues pohojnë se i njohin mirë ose shumë mirë prindërit e tjerë në klasë. Pjesa më e madhe e tyre gjithsesi thonë se mund të flasin lirshëm me prindërit e klasës për ndonjë shqetësim mbi fëmijën e tyre ose klasën. Një pjesë e madhe e prindërve përfaqësues thonë se janë prindër aktivë. Pak më shumë se gjysma e prindërve përfaqësues pohojnë se kontaktojnë vazhdimisht me prindërit e tjerë. Pjesa më e madhe mendojnë se janë efektivë në përcjelljen e interesave të prindërve që përfaqësojnë.

Qëndrimet tradicionale kundrejt bashkëpunimit

Pjesa më e madhe e prindërve (51%) mendojnë se bërja e mundur që fëmija të jetë i lumtur në shkollë është detyrë e shkollës dhe prindit njëkohësisht. Sipas tyre, arritjet e mira të fëmijës në shkollë janë sërish kryesisht detyrë e të dyve, por prindërit e përjashtuar nga ana sociale mendojnë se është përgjithësisht ose tërësisht detyrë e shkollës. Ndërkohë, prindërit shohin veten e tyre si personazhet kryesore në rritjen e fëmijës, edhe pse 43% mendojnë se përgjegjës janë si shkolla ashtu edhe prindërit. Prindërit shohin gjithashtu veten si përgjegjës për faktin që fëmija duhet të bëjë detyrat e shtëpisë. Prindërit dhe shkolla janë vlerësuar pothuajse njësoj përsa i takon motivimit për të mësuar, dhe përqindja më e lartë e prindërve (47%) mendojnë se duhet të jenë të dy. Sigurimi i një mësimdhënieje të mire, organizimi i aktiviteteve jashtëshkollore, vendosja e sigurisë në shkollë shihen nga prindërit gjerësisht si detyra të shkollës. Por nga ana tjetër, prindërit shohin veten e tyre si përgjegjës për të ditur çfarë është më e mira për fëmijën e tyre. Ndërhyrja ndaj diçkaje që nuk shkon mire në shkollë shihet nga prindërit si një detyrë e përbashkët me shkollën.

Këto gjetje janë në përputhje me informacionin e marrë nga prindërit në grupet e fokusuara. Sipas tyre, roli i tyre në shkollim është të ndihmojë me detyrat e shtëpisë, të mësojë fëmijën si të komunikojë dhe si të sillet, të përshtatet me moshën e fëmijës dhe të komunikojë me mësuesit.

2.4 Përfitimet e perceptuara të përfshirjes së prindërve

Prindërit u pyetën në lidhje me përfitimet që sjell përfshirja e tyre në jetën e shkollës dhe rezultatet e tyre janë si më poshtë:

Gjashtëdhjetë e gjashtë përqind e prindërve mendojnë se fëmija është i lumtur në shkollën ku ka përfshirje të prindërve.

Shtatëdhjetë përqind e tyre mendojnë se rezultatet e larta në mësim janë një tjetër përfitim. 68% mendojnë se fëmija argëtohet me pjesën tjetër të jetës së shkollës që s'ka të bëjë vetëm me mësimet dhe se fëmija do të arrijë rezultate në më të mirën e mundshme të tij.

Pjesa më e madhe e prindërve (72%) mendojnë se ata mund të përfitojnë personalisht nga pjesëmarrja duke marrë ndihmë nga prindërit e tjerë jo doemos të lidhur me fushën e shkollës.

Gjashtëdhjetë e gjashtë përqind e prindërve mendojnë se duke u përfshirë në jetën e shkollës, shkolla bëhet një vend më i sigurtë për fëmijën e tyre. Në grupet e fokusuara, prindërit u shprehën se duke marrë pjesë në shkollë, ata do të ishin më pranë fëmijës së tyre.

Shtatëdhjetë e dy përqind e prindërve mendojnë se cilësia e mësimdhënies rritet nga pjesëmarrja e prindërve në jetën e shkollës.

Gjashtëdhjetë e tre përqind e prindërve mendojnë se trajtohen me respekt nga shkolla.

Shtatëdhjetë e tetë përqind e prindërve mendojnë se sasia dhe cilësia e informacionit që do të marrin nga shkolla do të jetë e kënaqshme.

Prindërit që morën pjesë në grupet e fokusuara përmendën disa përfitime nga përfshirja në jetën e shkollës si: njohja më mirë e problemeve të moshës së fëmijës, ndikimi në arsimin e fëmijës, fakti se do të ndjehen të sigurtë dhe të vlerësuar, fëmija do të mësonte më shumë dhe do të ndjehej i sigurtë duke pasur prindërit pranë. Nga përfshirja e prindërve do të përfitonin si prindërit edhe shkolla sipas tyre.

III Përfundime dhe rekomandime

3.1 Përmbledhje e gjetjeve nga variablat e përbërë

- Pjesëmarrja e prindërve në forma si: takimet me prindër, leximi i informacionit të dërguar nga shkolla, dhënia e ndihmës fëmijë gjatë procesit të nxënies, pjesëmarrja në vendimmarrje shihen si të rëndësishme nga prindërit pavarësisht nga zona ku banojnë, por kjo kryesisht nga prindër të cilët *nuk* janë të përjashtuar në aspektin social.
- Prindërit që ndjehen të aftë për të marrë pjesë në jetën e shkollës janë kryesisht nëna, prindër që banojnë në Tiranë, si edhe prindër që nuk janë të përjashtuar nga ana sociale.
- Prindërit në përgjithësi shohin përfitime nga pjesëmarrja në jetën e shkollës. Gjithsesi, ky qëndrim nuk është i përhapur tek prindërit që janë të përjashtuar nga aspekti social.
- Ndërkohë, prindërit e përfshirë në jetën e shkollës ndjehen të aftë në të gjitha aspektet e pjesëmarrjes, duke filluar nga pjesëmarrja në takime, deri në perceptimin e përfitimit që ka përfshirja apo në perceptimin e tyre si të aftë për të kontribuar.
- Është interesante që prindërit në Tiranë e shohin veten të përfshirë *aktivisht* më shumë krahasuar me prindërit në veri, jug apo Shqipëri të mesme. Është gjithashtu interesante që prindërit e përjashtuar nga ana sociale kanë një vlerësim të ngjashëm me prindërit e tjerë.
- Një pjesë e prindërve, sidomos ata që janë të përjashtuar në aspektin social, mendojnë se ata shihen si pengesa në pjesëmarrje.
- Është interesante që prindërit e përjashtuar në aspektin social e shohin shkollën kryesisht të hapur ndaj prindërve, duke e vlerësuar më të hapur sesa prindërit e tjerë.
- Prindërit e konsiderojnë sigurimin e lumturisë së fëmijës në shkollë si një rol të përbashkët me shkollën. Ndërkohë, rritja e fëmijës konsiderohet si roli i prindit më shumë se roli i shkollës nga të gjithë prindërit, sidomos nga prindërit e përjashtuar nga ana sociale përfshirë prindërit Romë.
- Prindërit që janë të përfaqësuar në shkollë kanë fëmijë që ndjehen më të kënaqur me shkollën në përgjithësi. Edhe fëmijët e tjerë ndjehen të kënaqur përgjithësisht. Një vlerësim më të ulët japin fëmijët nga grupet e përjashtuara nga ana sociale.
- Përgjithësisht prindërit, pavarësisht nga grupet që përfaqësojnë, ndjehen të kënaqur me komunikimin në shkollë. Megjithatë, prindërit që janë të përfaqësuar në shkollë dhe prindërit që jetojnë në zona urbane japin një vlerësim më të lartë të komunikimit me shkollën.
- Mundësia për ndikim në vendimmarrje në shkollë vlerësohet më pozitivisht nga prindërit që janë të përfaqësuar në shkollë, edhe pse vlerësohet pozitivisht përgjithësisht edhe nga prindërit e tjerë.
- Ndërmjet faktorëve të mësipërm ka disa korrelacione pozitive, pra sa më i fortë të jetë njëri prej tyre, aq më i fortë pritet të jetë edhe tjetri. Ka një korrelacion të fortë pozitiv (koeficienti 0.73) ndërmjet vlerësimit të prindit kundrejt dobisë si rezultat i pjesëmarrjes dhe shkollës së përgjegjësive për të marrë pjesë.

3.2 Përfundime kryesore

Gjetjet e këtij studimi konfirmojnë një numër *përfitimesh nga përfshirja* e prindërve në shkollë:

- Fëmijët janë më të kënaqur me shkollën nëse prindërit e tyre janë të përfshirë në jetën e saj. Ata kanë rezultate më të larta në mësim. Në shtëpinë e tyre ka më shumë libra.
- Prindërit që përfaqësohen në jetën e shkollës kanë aspirata më pozitive për shkollimin e fëmijës së tyre në të ardhmen.
- Këta prindër priren të jenë me arsim të lartë universitar ose pasuniversitar.

Një pamje ndryshe është ajo *e prindërve të përjashtuar nga ana sociale* dhe fëmijëve të tyre.

- Fëmijët e këtyre prindërve priren të mos e pëlqejnë shkollën krahasuar me fëmijët e tjerë dhe kanë gjithashtu rezultate më të ulta në mësim. Një pjesë e mirë e tyre nuk kanë asnjë libër në shtëpi.
- Prindërit e këtij grupi kryesisht shpresojnë që fëmija i tyre të përfundojë arsimin e detyrueshëm, pra aspiratat e tyre nuk shkojnë më tej.
- Këta prindër kryesisht kanë përfunduar vetëm arsimin e detyrueshëm. Ata nuk besojnë fort se ftesat e shkollës për të marrë pjesë janë të nevojshme.

Në drejtim të *dimensioneve të pjesëmarrjes*:

- Sipas prindërve, shkolla i fton *më rrallë* prindërit e përjashtuar nga ana sociale në takime me prindër. Është krijuar një lloj inertësie që është e vështirë të thyhet dhe sipas së cilës ftohen më shpesh ata prindër të cilët përfshihen në strukturat e shkollës. Në vijim të kësaj, prindërit e përjashtuar i pranojnë ftesat *më rrallë* dhe nuk besojnë mjaftueshëm në këto takime. Ata *nuk* e shohin veten të aftë se mund t'i përdorin këto takime në mënyrën e duhur. Ndërkohë që prindërit përfaqësues i pranojnë këto ftesa dhe besojnë më fort se shkolla e ka për detyrë t'i ftojë prindërit në takime.
- Prindërit përfaqësues janë ata që marrin më shpesh informacion të shkruar nga shkolla dhe janë më të prirur për ta lexuar atë.
- Një e treta e prindërve të përjashtuar nga ana sociale nuk mund t'i ndihmojnë fëmijët e tyre në detyrat e shtëpisë. Ndërkohë, prindërit përfaqësues kanë më shumë besim se mund ta bëjnë këtë. Fëmijët ndihmohen më shumë nga nënat në detyrat e shtëpisë. Baballarët janë disa herë më pak të prirur për të ndihmuar.
- Shkolla i fton rrallë prindërit Romë për të dhënë ndihmë vullnetare, por fton më shpesh prindërit përfaqësues në strukturat e saj.
- Mendimi për vendime të rëndësishme i kërkohet më shumë prindërve përfaqësues sesa prindërve të përjashtuar nga ana sociale. Prindërit e përjashtuar nga ana sociale nuk besojnë se shkolla duhet t'iu marrë mendim. Ata nuk janë të sigurtë se kanë aftësi të kontribuojnë në vendimmarrje. Ndryshe nga ata, prindërit përfaqësues kanë më shumë besim.
- Pjesa më e madhe e prindërve nuk e kanë marrë asnjëherë iniciativën për t'u organizuar në grupe me qëllimin për të ndikuar diçka në jetën e shkollës. Ata janë më të prirur për të marrë iniciativa individuale. Megjithatë, në këtë drejtim, prindërit e përjashtuar nga ana sociale janë më të prirur për t'u organizuar se prindërit e tjerë.
- Prindërve Romë përgjithësisht nuk iu është kërkuar të bëhen pjesë të strukturave të shkollës apo klasës. Ata vetë nuk ndjehen me vetëbesim për ta ndërmarrë këtë lloj roli.

Faktorë parashikues dhe ndërmjetësues

- Prindërit në një pjesë të mirë e shohin veten e tyre si pengesë për përfshirjen në shkollë. Prindërit në zonat rurale mendojnë se mësuesit komunikojnë më shpesh me ta, krahasuar me ata në zona urbane.
- Prindërit Romë nuk e perceptojnë shkollën si të hapur, sidomos nëse krahasohen me prindërit e tjerë. Fëmijët Romë e kanë të vështirë të mësojnë në shtëpi pasi nuk ka kush i ndihmon. Prindërit e tyre mendojnë se shkolla mund të bënte më shumë për t'i ndihmuar këta fëmijë.
- Prindërit përfaqësues në strukturat e shkollës nuk marrin vlerësimin maksimal nga ana e prindërve të tjerë. Ata nuk takohen rregullisht me prindërit dhe këta të fundit nuk i shohin doemos si efektivë në përfaqësim. Prindërit përfaqësues e perceptojnë se prindërit e tjerë kanë këtë lloj qëndrimi, pavarësisht se nuk janë të sigurtë. Nga ana tjetër, ata kanë një mendim më pozitiv për rolin që luajnë në shkollë duke e parë veten si aktivë dhe efektivë në rol.
- Një e treta e prindërve përfaqësues nuk janë zgjedhur nga prindërit e tjerë. Kjo tregon për një mungesë vendimmarrjeje nga ana e prindërve.
- Prindërit përfaqësues nuk besojnë se zëri iu dëgjohet, edhe pse në lidhje me këtë kanë mendime kontradiktore. Ata kryesisht nuk kanë qenë pjesë e vendimeve të rëndësishme për shkollën si menaxhimi financiar ose çështje arsimore si përmbajtja dhe vlerësimi i mësuesve.
- Qëndrimet e prindërve anojnë nga pikëpamja tradicionale e rolit të shkollës: sigurimi i një mësimdhënieje të mirë, organizimi i aktiviteteve jashtëshkollore, vendosja e sigurisë në shkollë shihen gjerësisht si detyra të shkollës. Ndërkohë, prindërit shohin rolin e tyre në rritjen e fëmijës dhe faktin që fëmija duhet të bëjë detyrat e shtëpisë. Megjithatë, për një seri rolesh si lumturia e fëmijës në shkollë, arritjet e mira në shkollë dhe motivimi për të mësuar ata shohin se si prindërit ashtu edhe shkolla janë përgjegjës.
- Prindërit në përgjithësi i perceptojnë ose i artikulojnë përfitimet që mund të sjellë përfshirja e tyre në shkollë.

3.3 Rekomandime

Ky studim kishte si objektiv të zbulonte qëndrimet dhe pikëpamjet e prindërve mbi bashkëpunimin shkollë – prindër si edhe me marrëdhëniet e deritanishme të tyre. Gjetjet do të shërbejnë si bazë për të hartuar, formuluar dhe zbatuar iniciativa që do të ndryshojnë situatën, pra që do të synojnë ndryshimin e problemeve që në rrënjë. Duke pasur parasysh drejtimet kryesore të gjetjeve, rekomandimet tona i drejtohen jo vetëm vendimmarrësve në nivel qendror apo lokal, por edhe aktorëve të tjerë të arsimit, të cilët, në përputhje me parimin e përfshirjes, kanë gjithashtu rolin dhe përgjegjësitë e tyre.

Programe me bazë në shkollë, që synojnë shkaqet rrënjë të problemit

Në mënyrë që situata të ndryshojë, nevojitet që të ndërmerren programe të cilat e adresojnë çështjen e përfshirjes nga pikëpamja e cilësisë në arsim. Është cilësia në arsim që duhet të jetë vizioni i dëshiruar i çdo aktori të lidhur ose të ndikuar nga jeta e shkollës, me pak fjalë e çdo qytetari dhe e të gjithë shoqërisë. Në këtë kuadër, përfshirja është një nga mënyrat e pashmangshme për ta arritur cilësinë.

Nga njëra anë, kemi drejtues shkolle që njohin parimet e përfshirjes të paktën në parim, nga ana tjetër, kemi prindër të cilët janë në gjendje të artikulojnë përfitimet që ka përfshirja e tyre. Megjithatë, edhe pse kemi drejtorë shkollash që janë trajnuar në këtë fushë dhe janë përpjekur, nga ana tjetër, kemi prindër që rrallë e aktualizojnë përfshirjen. Studimi tregoi se në rrënjë të këtij pasiviteti të prindërve ndodhet besimi se “shkolla nuk i fton”, “shkolla i do prindërit vetëm për disa vendime, por jo për më të rëndësishmet”, “ata si prindër nuk janë të aftë që të kontribuojnë” apo “duhen prindër me nivel intelektual të lartë që të kontribuojnë siç duhet.” Pra, një nga problemet rrënjë qëndron në mënyrën si e perceptojnë prindërit shkollën dhe rolin e tyre. Për këtë arsye, rekomandojmë që të hartohen programe ndërgjegjësimiti, të cilat të zbatohen në mënyrë të decentralizuar, pra, të mbështetura nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, ose institucione të tjera, por të zbatuara nga shkolla, si institucioni arsimor më pranë prindit. Nëse këto programe ndërgjegjësimiti do të kishin origjinën në shkollë, atëherë do të kishin një efekt më të madh tek prindërit dhe komuniteti, pasi ata do ta shihnin shkollën të interesuar për përfshirjen e tyre.

Përfshirja fillon nga përfshirja

Nëse ka dhe do të vazhdojë të ketë programe ose iniciativa që nxisin përfshirjen, atëherë ato duhet të ftojnë prindërit të jenë pjesë e tyre që në konceptim dhe deri në zbatim dhe monitorim të këtyre iniciativave. Prindërit duhet të ftohen në tryezat ku diskutohen këto programe ose iniciativa dhe gjetjet e studimeve si ky i paraqitur këtu, duhet të ndahen me ta. Prindërit duhet të ndiejnë se janë të dëgjuar, se pjesa e vendimmarrësve dhe manaxhuesve të shkollës janë të interesuar për mendimin e tyre dhe i vlerësojnë. Parimi i përfshirjes duhet të fillojë të zbatohet pikërisht në programet e përfshirjes.

Është e rëndësishme që prindërit të bëhen pjesë në një mënyrë që i shërben si shkollës, ashtu edhe fëmijës dhe prindërve vetë. Sidomos prindërit e përjashtuar nga ana sociale nuk ndjeheshin të aftë për të përdorur në mënyrën më të mirë forma të pjesëmarrjes si p.sh. takimet në shkollë. Për këtë arsye, duhet të gjenden mënyra për t'i përfshirë ata duke iu rritur interesin dhe besimin në përfitimin tek pjesëmarrja. Për më tepër, prindër nga strukturat përfaqësuese mund të përfshihen në angazhimin e sa më shumë prindërve në takime të shkollës dhe/ose klasës, në dhënien e ndihmës vullnetare apo ndihmës për organizimin e aktiviteteve të shkollës.

Vëmendja tek të përjashtuarit nga shoqëria

Është e vështirë të thyesh rezistencën brenda prindërve në lidhje me rolin që ata mund të luajnë, sidomos tek ata prindër që i përkasin grupit të përjashtuar nga shoqëria përfshirë edhe Romët. Gjetjet e studimit konfirmojnë se prindërit Romë e ndiejnë veten më të paaftë për të kontribuar. Ata shprehen se mendimi i tyre nuk merrej plotësisht dhe se nuk ftoheshin për të marrë pjesë në takime apo në vendimmarrje. Ç'është më e rëndë, fëmijët e tyre ishin dukshëm në një pozicion më pak të favorizuar sesa fëmijët e tjerë. Nuk është e qartë nëse mungesa e përfshirjes është shkaktari kryesor i gjendjes, por, siç e mbështesin edhe gjetjet e studimit, është një nga faktorët që e bashkëshoqëron atë.

Shkolla dhe grupe të tjera të interesit si organizatat që mbrojnë interesat e këtyre grupeve apo komuniteti duhet të punojnë në mënyrë të veçantë me këtë grup, për të rritur vetëbesimin tek prindërit Romë. Do të ishte gjithashtu e rëndësishme që ata të njiheshin dhe ndërgjegjësoheshin për përfitimet që vijnë nga përfshirja e tyre.

Nga inertësia në ndryshim

Nga ana tjetër, çështja e pjesëmarrjes nuk mund të adresohet vetëm duke rritur besimin e grupeve të përjashtuara. Një nga arsytet pse prindërit besojnë se nuk janë të aftë, është se nuk ftohen shpesh, ose jo aq shpesh sa prindërit e tjerë, sidomos ata që janë përfaqësues në strukturat e shkollës. Është pikërisht shkolla, administrata e saj dhe institucionet që e drejtojnë që duhet të ndryshojnë besimin dhe qëndrimin duke thyer inertësinë e angazhimit të atyre prindërve “që vijjnë dhe interesohen”. Shkolla ka shumë nevojë edhe për prindërit që s’kanë ardhur kurrë në takime, apo që s’lexojnë kurrë dëftesën e fëmijës. I takon asaj të njihet me këta prindër dhe i takon ekspertëve të arsimit të gjejnë mënyrat e duhura dhe mënyra krijuese për të përcjellë njohuritë dhe informacionin tek prindërit, si edhe për t’i përfshirë ata në jetën e shkollës.

Ndryshimi fillon me hapa të vegjël

Shkolla duhet të jetë në dijeni të ndikimeve të faktorëve të ndryshëm dhe të përpiqet të angazhojë prindërit gradualisht dhe jo në mënyrë të sforcuar. Faktorët që ndikojnë janë mirëqenia në familje e cila lidhet ngushtë me arsimimin e nënës, me rezultatet e larta të fëmijës, me pëlqimin e shkollës, me pasjen e më shumë librave, etj. Shkolla duhet të dalë mbi paragjykimet, të kuptojë si lidhen faktorët me njëri-tjetrin, si ndikojnë ata përfshirjen dhe të dijë të përfshijë sa më shumë fëmijë e prindër të përjashtuar. Meqënëse faktorët janë të lidhur me njëri-tjetrin, mund të jetë e dobishme që të ndikohen disa prej tyre, në mënyrë që ndryshimi të prekë dhe të tjerët. Kësisoj, nëse fëmijët me rezultate të dobta kanë më pak libra, atëherë mund t’ju kërkohet të përfshihen më shumë në bibliotekë, apo t’ju kërkohet fëmijëve që kanë për t’ua huazuar. Gjestet e vogla mund të nxisin ndryshime të mëdha.

Mirëfunksionimi i strukturave përfaqësuese të prindërve

Këshillat e prindërve dhe bordet e shkollës duhet të fillojnë të funksionojnë në mënyrën e duhur për të fituar jo vetëm besimin dhe mbështetjen e prindërve që përfaqësojnë, por mbi të gjitha, për të ndikuar jetën e shkollës, duke kryer kështu misionin për të cilin janë krijuar. Për këtë arsye, shkolla duhet të ndihmojë në funksionimin e tyre, të jetë asnjënjë dhe objektive, të mbështesë prindërit që të luajnë sa më mirë rolin e tyre. Këto struktura duhet të fillojnë të ndiejnë se ekzistojnë për një qëllim dhe se janë efektive, që ekzistenca e tyre ka një kuptim të rëndësishëm. Strukturat nuk mund të jenë struktura per se, por duhet të përfaqësojnë maksimalisht grupet e prindërve. Ato nuk duhet të jenë të shkëputura prej tyre, por përkundrazi të mbajnë lidhje të vazhdueshme për të siguruar që opinionet dhe nevojat e prindërve po përfaqësohen në vazhdimësi. Këto struktura duhet të luajnë rolin për të cilin janë krijuar dhe jo të ekzistojnë në letër apo në mënyrë artificiale.

Bibliografi

Center for Democratic Education, (2008). Unedited Report. *Parent Participation in School Life Albania Report*. Advancing Educational Inclusion and Quality in SEE Project. December. p.13

CDE, (2008). Study Report. *On the Assessment of the Achievements of parental Involvement in Education in Albania and the Setting of Benchmarks for the Future*. Prepared by Linda Gjermani and Bardhyl Musai. Supported by Unicef. March. p.42-43.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, (2007), Udhëzim Nr. 40, datë 17.10.2007 “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të shkollës.”

Shtojca: Instrumenti i studimit

Udhëzime të përgjithshme

Duke filluar nga pika e nisjes, intervistuesi do të vizitojë njërën pas tjetrës shtëpitë derisa të gjendet shtëpia e cila ka fëmijë:

- Që shkojnë në njërën nga shkollat në kampion.
- Ndërmjet moshës 8 dhe 13 vjeç , p.sh. ndërmjet ditëlindjes së 8-të dhe të 14-të.
- Që janë të paktën në klasë të dytë të shkollës fillore.

Në këtë shtëpi, intervistuesi vazhdon me intervistën. Nëse ka më shumë se një fëmijë të këtitë, do të përzgjidhet ai fëmijë emri i të cilit vjen i pari për nga rendi alfabetik.

I intervistuari do të jetë nëna e fëmijës, përveçse në rastet kur nëna nuk është e disponueshme gjatë kohës së vizitës ku i intervistuari do të jetë babai. Nëse asnjëri nga prindërit nuk është i disponueshëm në vizitën e parë , intervistuesi do të caktojë një kohë të re takimi për të bërë intervistën, duke u munduar që të flasë me nënën dhe duke caktuar një intervistë me babain vetëm nëse nëna nuk është e arritshme në një kohë të arsyeshme. Nëse gjatë kësaj kohe as nëna dhe as baba nuk kujdesen për fëmijën, intervistuesi do të kërkojë të flasë me cilindo person që ka në kujdes fëmijën (p.sh. gjyshërit). Nëse nuk janë të arritshëm për momentin, intervistuesi do të caktojë një takim në një kohë tjetër për intervistën.

- A INFORMACION MBI RRETHANAT E PËRGJITHSHME
- (PLOTËSOHET NGA INTERVISTUESI PARA INTERVISTËS)

A1. Emri i intervistuesit: _____	
A2. Kampioni	1. Kampioni A (shumica – kampioni i prindërve të zakonshëm)
A3. Gjuha e intervistës	Shëno _____
A4. Vështirësi të veçanta	Shëno _____
A5. Statusi minoritar <i>[ANK] Nëse i anketuari është minoritet atëherë shënoni cilit minoritet i përket, nëse jo mos e lini bosh po shënoni që NUK i përket asnjë</i>	Shëno _____

Përsëritet, më lejoni të prezantohem, emri im është ----- dhe përfaqësoj Strategic Puls Research (Stratexhik Puls Risërc) e cila është duke kryer një studim mbi bashkëpunimin shkollë-prindër. A keni ndonjë fëmijë në shkollën XY⁴. Do të doja t'ju drejtoja disa pyetje mbi përvojat dhe opinionet tuaja në lidhje me shkollën në të cilën bën mësim fëmija juaj dhe nëse keni ndonjë kontakt me shkollën në lidhje me fëmijën tuaj. Intervista do të zgjasë rreth 25 minuta dhe pjesëmarrja është tërësisht në vullnetin tuaj.

Rezultatet e studimit do të na ndihmojnë të kuptojmë llojet e kontakteve që kanë shkollat dhe prindërit – çfarë pritshmëri kanë drejtorët e shkollave nga prindërit dhe çfarë pritshmëri kanë prindërit nga mësuesit dhe drejtorët.

⁴ Nëse ka më shumë se një fëmijë të këtitë, atëherë do të identifikohet fëmija emri i të cilit vjen i pari për nga rendi alfabetik

Përgjigjet tuaja do të mbahen të fshehta dhe ato do të përdoren vetëm për qëllime studimore.

• B TË DHËNA SOCIO-DEMOGRAFIKE			
B1 FËMIJA NË FOKUS			
<i>B1A Të përgjithshme</i>			
B1A1	Gjinia e fëmijës:	1. Mashkull 2. Femër	B1A2
B1A2	Mosha e fëmijës në vite të mbushura:	Shëno ____ ____	B1A3
B1A3	Niveli shkollor (klasa):	Klasa e : _____	B1B1

<i>B1B Shkolla</i>			
B1B1	Si ndihet përgjithësisht fëmija juaj në lidhje me vajtjen në shkollë?	1. E urren 2. Nuk i pëlqen 3. I pëlqen 4. E ka me shumë qejf	B1B2
B1B2	Si do ta vlerësonit arritjen e përgjithshme të fëmijës tuaj në shkollë?	1. dobët 2. nën mesatare 3. mesatare 4. mbi mesatare 5. shkëlqyeshëm	B1B3
B1B3	A ka fëmija juaj ndonjë vështirësi në shkollë, siç mund të jetë: <i>[INT] Më shume se një përgjigje. Rrethoni të gjitha që përputhen.</i>	1. Vështirësi në të mësuar 2. Probleme në sjellje 3. Komunikim me mësuesit dhe stafin 4. Marrëdhënia me bashkëmoshatarët 5. Diçka tjetër, çfarë? _____ 6. nuk ka vështirësi	B1B4
B1B4	A ka nevojë fëmija juaj për vëmendje të veçantë në shkollë për shkak të ndonjë nevoje speciale – shëndetësore/paafhtësi, mësimore, diçka tjetër? <i>[INT] Nevojat mësimore speciale: Fëmija mund të ketë ndonjë problem fizik, mjekësor apo psikologjik ose problem me të mësuarit ose ndonjë paafhtësi e cila e bën më të vështirë për të që të mësojë apo të ketë akses në shkollë (p.sh. hyrja brenda në shkollë) në krahasim me shumicën e fëmijëve të së njëjtës moshë.</i>	1. Jo 2. Po, nëse po, pse? _____	B2A1

B2 RRETHANAT E PERSONIT KUJDESTAR DHE FAMILJES			
---	--	--	--

B2A1	Sa libra keni në shtëpinë tuaj? (libra për të rritur dhe për fëmijë, pa përfshirë librat shkollorë)	1. Asnjë 2. 1-10 libra 3. 11-50 libra 4. 51-100 libra 5. 101-250 libra 6. 251-500 libra 7. Më shumë se 500 libra	B2B1
------	---	--	------

B2B <i>Indeksi i mirëqënies</i>			
	A keni në shtëpine tuaj ...?		
B2B1	Ujë të ftohtë të rrjedhshëm	1. Po 2. Jo	B2B2
B2B2	Ujë të ngrohtë të rrjedhshëm	1. Po 2. Jo	B2B
B2B3	Vaskë ose dush	1. Po 2. Jo	B2B
B2B4	Banjo brenda shtëpisë	1. Po 2. Jo	B2B
B2B5	Sobë për gatim	1. Po 2. Jo	B2B
B2B6	Frigorifer	1. Po 2. Jo	B2B
B2B7	Makinë larëse rrobash	1. Po 2. Jo	B2B
B2B8	Makinë larëse enësh	1. Po 2. Jo	B2B
B2B9	Ajër të kondicionuar	1. Po 2. Jo	B2B
B2B1	Një kompjuter	1. Po 2. Jo	B2B
B2B1	Një lidhje me internetin	1. Po 2. Jo	B2B
B2B1	Një telefon celular	1. Po 2. Jo	B2B
B2B1	Një telefon fiks	1. Po 2. Jo	B2B14
B2B14	Një makinë	1. Po 2. Jo	B2B15
B2B15	A janë të gjitha dhomat e banesës tuaj me ngrohje gjatë stinës së dimrit	1. Po 2. Jo	B2B
B2B1 6	A kanë gjithsecili prej fëmijëve tuaj të cilët shkojnë në shkollë tavolinën e tyre të shkrimit në shtëpine tuaj	1. Po 2. Jo	B2C 1

B2C <i>I Intervistuari</i>																					
